

Raport individual për rezultatin e konsultimit publik për projektligjin “Për Shkencën në Republikën e Shqipërisë”

1. Titulli i projektligjit

Projektligji “Për Shkencën në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Konsultimi paraprak i këtij dokumenti ka nisur brenda institucionit që në fazën e hartimit të draftit fillestar dhe komentet/sugjerimet janë finalizuar në versionin e parë të këtij dokumenti.

Dokumenti u publikua në RENJK në adresën “konsultimipublik.gov.al”, në datën 04.07.2023 për marrjen e komenteve dhe rekomandimeve nga qytetarët dhe shoqëria civile, deri në datën 01.08.2023, duke respektuar afatin prej 20 ditë pune

3. Metoda e konsultimit

Metodat e konsultimit të përdorura për Projektligjin “Për Shkencën në Republikën e Shqipërisë”, janë si më poshtë vijon:

Takime me grupet e interesit: Janë zhvilluar takime në nivel teknik me Konferencën e Rektorëve dhe Akademinë e Shkencave, si dhe Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor.

Publikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në link-un: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/645>

Nëpërmjet adresës së e-mailit:

Projektligji është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (<https://arsimi.gov.al/njoftim-per-konsultim-publik-te-projektligjit-per-shkencen-nerepubliken-e-shqiperise/>), duke mirëpritur sugjerime në rubrikën e dedikuar për konsultimin publik, ku krahas drafteve të projektligjit janë vënë në dispozicion për të mirëpritur sugjerime edhe adresat elektronike si më poshtë: matilda.bulku@arsimi.gov.al dhe nadire.pilavi@arsimi.gov.al

Nëpërmjet adresës postare:

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail: info@arsimi.gov.al. Çdo palë e interesuar pati mundësinë të dërgojë në formë shkresore, në adresë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të gjitha komentet/sugjerimet mbi përmbajtjen e projektligjit.

4. Palët e interesit të përfshira

Projektligji "Për shkencën në Republikën e Shqipërisë" u publikua për konsultim në RENJK, por do të ripublikohet për konsultim publik në vijim të bashkëpunimit institucional për përmirësimin e projektligjit me Akademinë e Shkencave dhe Konferencën e Rektorëve. Projektakti është riplanifikuar në PPAP 2024 dhe planin e konsultimit publik për vitin 2024.

Kontribut kanë dhënë gjatë procesit të konsultimit grupet e interesit, por dhe aktorë të tjerë në nivel qendror si ministrinë e linjës.

Procesi i konsultimit nuk është shoqëruar me komente pas publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.